



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

SESIONI II

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme artistike; koreografike; sportive; me kohë të shkurtuar

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**MARTESA E HALILIT** (fragment)

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	C	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë

Pyetja 8 3 pikë**Model përgjigjeje**

- a- Ngjarja kryesore këtu është kuvendi i burrave dhe diskutimi mbi martesën e Halilit.
 b- E papritura lidhet me vargun e fundit; *Ja e kam marrë Tanushën e Krajlit!*
 Efekti që ajo krijon është i lidhur me atë që e pret lexuesin më pas....mrekullues, surprizues etj.

3 pikë	Nëse jep ngjarjen kryesore dhe zbulon vargun surprizues, duke i bashkangjitur atij edhe efektin mrekullues.
2 pikë	Nëse jep vetëm ngjarjen kryesore së bashku me një nga elementët e pikës b, ose nëse jep vetëm pikën b të plotë pa përgjigjen a.
1 pikë	Nëse jep vetëm njërën nga përgjigjet a ose b.
0 pikë	Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 9 3 pikë**Model përgjigjeje**

- a- rimë foljore krijojnë ato vargje që rimojnë me folje si:
 “S’e kam lanë për pare pse **nuk pata,**
 s’e kam lanë, për vashë pse **n’u mund hasa. Etj.**
- b- rimë emërore krijojnë ato vargje që rimojnë me emra si:
 At’herë trimi u ka avitë **bucelat,**
 at’herë trimi u ka avitë **fucijat; Etj.**
- c- Rimat i japin muzikalitet dhe ritëm këngës ose vargjeve.

Shënim: nxënësi mund të japë vargjet ku formohen rimat ose vetëm fjalët përkatëse që formojnë ato. Nxënësi mund të japë çdo shembull nga fragmenti me këto tregues.

3 pikë	Nëse jep dy shembuj për secilën rimë dhe gjen se përse shërbejnë rimat.
2 pikë	Nëse jep vetëm dy rimat ose nëse jep njërën nga rimat dhe përgjigjen për pikën c.
1 pikë	Nëse jep vetëm njërën nga rimat ose vetëm përgjigjen e pikës c.
0 pikë	Nëse përgjigja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 10 **3 pikë****Model përgjigjeje**

a- Vargjet për **pyetjen a** janë:

At'herë trimi u ka avitë bucelat,

at'herë trimi u ka avitë fucijat;

i'n bucelat plot raki,

i'n fuçijat plot venë.

Shënim: vargjet mund të jepen edhe të pjeshme ose me perifrazim.

b- Vargjet për **pikën b** janë:

tridhjetë agë kanë me u bashku,

tridhjetë vashat t'i kanë pru:

njat ma t'mirën ke me e zgjedhë.

Tridhjetë agë për hajr ta bajmë".

Shënim: vargjet mund të jepen edhe të pjeshme ose me perifrazim.

c- këto vargje ndihmojnë në paraqitjen e panoramës së asaj kohe, na japin të dhëna mbi traditat dhe zakonet popullore. (**shënim:** çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të pikës c, do të merret si pozitive).

3 pikë Nëse nxënësi gjen traditën e gostitjes, nëse gjen ku përdoret numri tridhjetë dhe jep rëndësinë e përdormit të tyre.

2 pikë Nëse nxënësi përgjigjet vetëm për dy nga pikat më lart.

1 pikë Nëse nxënësi përgjigjet vetëm për një nga pikat më lart.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Njeriu burrë paraqitet si njeri që shijon në mënyrën më të thjeshtë pijen. Kjo e bën atë më argëtues. Kënga thotë më poshtë vargjeve: *Kanë marrë gazin e po gazmojnë.* etj
- Njeriu trim jepet si gjaknxehtë që menjëherë merr peshë nga pija. Kjo i ndez atyre kuvendimin si në rastin e këngës. Kënga thotë më poshtë: *kanë marrë llafin e po llafitin.*etj.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

2 pikë Nëse jep ndryshimin midis dy karakteristikave që shfaq këngëtari popullor për burrat.

1 pikë Nëse gjen vetëm njërën pa e krahasuar me tjetrën..

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 **3 pikë****Model përgjigjeje**

a- Tregon mikrpritjen etj.

b- Muji është i pari i familjes, më i forti dhe njeriut që i dëgjohe më fort fjala, etj.

c- Përemër.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

3 pikë	Nëse jep tri përgjigje si më lart.
2 pikë	Nëse jep dy nga përgjigjet si më lart.
1 pikë	Nëse jep vetëm një nga përgjigjet si më lart.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II

BALZAK

EVGJENI GRANDE (fragment)

Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	B	1 pikë
Pyetja 15	C	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë

Pyetja 19 2 pikë

Model përgjigjeje

- a) Fatkeqësia e Evgjenisë është e lidhur me mosrealizimin e dashurisë së saj, por edhe me vuajtjen që ajo po përjetonte nga sjellja e Karlit.
- b) Kureshtja e vizitorëve është e lidhur me faktin se si do të reagonte Evgjenia nga lajmet mbi ardhjen e Karlit në qytet dhe thashethemet rreth tij.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

2 pikë	Nëse gjen fatkeqësinë e Evgjenisë dhe shpjegon nga vjen kureshtja e vizitorëve.
1 pikë	Nëse gjen vetëm një nga përgjigjet
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 3 pikë

Model përgjigjeje

a dhe b- Detajet që tregojnë se Evgjenia e zotëronte veten janë:

- Mbajti një gjakftohtësi shembullore,
- Asnjë nga brengat nuk u shfaq në fytyrë,
- U përgjigj me buzëqeshje,
- Fshehu fatkeqësinë e vet,
- Etj.

c-

- Ndryshimi që ka pësuar Evgjeni është i lidhur me natyrën e saj.
- Dikur ajo ishte shumë delikate dhe reagonte menjëherë qoftë edhe nga një e bërtitur e të atit.
- Tashmë ajo mund të fshihte fatkeqësinë e vet, pa e kuptuar njeri.
- Ajo e zotëronte veten plotësisht.

- Ishte bërë me e sofistikuar.
- Etj.
-

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

- 3 pikë** Nëse gjen dy detajet dhe shpjegon ndryshimin e Evgjenisë.
2 pikë Nëse gjen vetëm dy detajet ose vetëm njërin detaj dhe shpjegimin e kërkuar.
1 pikë Nëse gjen vetëm njërin detaj ose vetëm shpjegimin e kërkuar.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 3 pikë

Model përgjigjeje

a-

Njerëzit që rrethojnë Evgjeninë i çudit e papritura që ishte e lidhur me kërkesën që ajo i bën kryetarit për të qëndruar pas të tjerëve. Kjo gjë mori dhenë në qytet sepse nuk kishte ndodhur kurrë më parë dhe kishte një domethënie të madhe.

b- - Kjo lodër na qenka ç'na qenka! Më e mira nga të gjitha!- tha prifti.

c- Për të treguar çudinë e të gjithëve, për të treguar absurdin e lidhur me situatën dhe vendimarrjen e Evgjenisë (Karli që kthyer me marrëzitë e tij dhe për këtë shkak Evgjenia po martohej), për të treguar kotësinë e kësaj martesë e cila dihej përse bëhej, për të treguar dhe një lloj ndjesie të të gjithëve aty që dukej sikur e kishin menduar këtë gjë më parë, etj.

- 3 pikë** Nëse jep tri përgjigje të ngjashme me modelin a) b) c).
2 pikë Nëse jep vetëm dy nga përgjigjet sipas modelit a) b) c).
1 pikë Nëse jep vetëm njërin nga përgjigjet sipas modelit a) b) c).
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë

Model përgjigjeje

a + b: Evgjenia vendos të martohet sepse:

- Karli kthehet në qytet dhe nuk kujtohet më për të.
- Karli kthehet në qytet dhe thashethemet rreth tij shkatërrojnë plotësisht ëndrrën e saj.
- Sepse dashuria e saj e vetme mori fund, tashmë i duhej të bënte një martesë për interesa të caktuara.
- Për të pasur një zot të pasurisë së saj.
- Për t'i bërë ballë rreziqeve të jetës.
- Për të pasur një njeri që mund të mbronte atë dhe pasurinë e saj.
- Sepse kështu e kërkonte zakoni.
- Etj .

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

- 2 pikë** Nëse jep dy arsye të martesës së Evgjenisë.
1 pikë Nëse jep një arsye të martesës së Evgjenisë
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **3 pikë****Model përgjigjeje****Kushtet janë:****a-**

- ai nuk duhet të kërkonte asnjë të drejtë mbi zemrën e saj,
- asnjë të drejtë që ia lejon martesë burrit ndaj gruas.

b-

- shërbimin ndaj shlyerjes së borxheve të të ungjit,
- kujdesin për të dhe pasurinë e saj.
- Etj.

c-

- Kryetari ishte i gatshëm të bënte gjithçka,
- u drodh nga gëzimi dhe nga ankthi,
- u ndje si skllav i saj,
- etj.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

3 pikë	Nëse identifikon dy kushte të ndryshme dhe tregon si ndihet kryetari.
2 pikë	Nëse tregon vetëm dy kushte ose njërin nga ato dhe tregon si ndihet kryetari
1 pikë	Nëse tregon vetëm një nga kushtet ose tregon vetëm si ndihet kryetari
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **2 pikë****Model përgjigjeje**

a- Sjellja e kryetarit është sjellja e një të binduri, e një skllavi, e një njeriu i cili bën gjithçka për të pasur nën sundim një pasuri aq të madhe etj.

b- Gjithë peshën e shprehjes së fjalëve të tij e mban fjala skllav. Ai pranon gjithë kushtet e Evgenisë pa llogaritur asgjë për veten e tij. Bindja prej skllavi është në funksion të një interesi material shumë të madh, siç është pasuria dhe paraja.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

2 pikë	Nëse jep përshtypjen dhe shpjegon fjalën e kryetarit.
1 pikë	Nëse përgjigjet vetëm për njërin nga ato.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton pse dëshira e tepërt për para e tjetëron njeriun.
- shpjegon pse ndodh kjo dhe si ndodh kjo.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.

- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 2 pikë**1 pikë Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE 2 pikë**(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.